

## Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara parasheh se gjendja e aftësive të kufizuara "rezulton nga ndërveprimi midis personave me dëmtime dhe barrierave të qëndrimeve dhe të ambientit të cilat pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efikase në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët", dhe e vendos respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në kornizën e mbrojtjes dhe të përkrahjes së të drejtave të njeriut.

Bazuar në këtë parim Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara siguron të drejtave të barabarta edhe për personat e shurdhër ku njihet gjuhët e shenjave si gjuhë dhe i konsideron të barabarta me gjuhët e folura (Kapitulli 2).

KDPAK e realizon këtë duke vënë në pah se shtetet duhet të njohin (zyrtarizojnë) gjuhët e shenjave dhe të ofrojnë e shërbime të cilat do të jenë të disponueshme në gjuhën e shenjave sepse vetëm në këtë mënyrë do të sigurojnë të drejtat e barabarta për personat e Shurdhër.

Rruga të cilën shtetet kanë ndjekur për Zyrtarizimin e gjuhës së shenjave është e ndryshme. Deri më tani ekzistojnë shtete të cilat kanë zyrtarizuar gjuhët e shenjave në:

- Kushtetutat e tyre
- Në legjislatcion: si në ligjin e gjuhës së shenjave, ligjin e edukimit, ligjin antidiskriminim apo me vendimet parlamentare
- Si dhe zyrtarizimin e Gjuhës së Shenjave me vendim të Qeverisë

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara e trajtojnë shumë mirë këtë çështje si në vijim:

### Neni 2

"Komunikim" përfshin gjuhët, shfaqje teksti, Braille, komunikimin me prekje, printim me font të madh multimedia e aksesueshme si dhe gjuhë të qartë, audio dhe të shkruar, lexues (person që lexon) dhe mënyra, mjetet dhe forma komunikimi shtesë apo alternative, përfshirë informacion dhe teknologji komunikimi të aksesueshëm.

"Gjuha" përfshin gjuhën e folur dhe gjuhën e shenjave si dhe forma të tjera të gjuhës jo-të folur;

"Diskriminim me bazë aftësinë e kufizuar" do të thotë që çdo dallim, përjashtim apo kufizim me bazë aftësinë e kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në dëmtimin apo anulimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, mbi baza të barabarta me të tjerët, e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Ky përkufizim përfshin të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë dhe mohimin e akomodimit të arsyeshëm;

"Akomodim i arsyeshëm" do të thotë modifikime dhe përshtaje të nevojshme e të përshtatshme duke mos imponuar një barrë disproporcionale, kur është e nevojshme në raste të veçanta, për t'i siguruar personave me aftësi të kufizuara gëzimin dhe ushtrimin e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut me baza të barabarta me të tjerët;

"Projektim universal" do të thotë projektim i produkteve, ambjenteve, programeve dhe shërbimeve që të jenë të përdorshme nga të gjithë njerëzit, në masën më të madhe të mundshme, pa pasur nevojë për adaptim apo projektim të specializuar. "Projektimi universal nuk duhet të përjashtojnë paisjet asistuese për grupe të veçanta të personave me aftësi të kufizuara, kur është e nevojshme.



Shoqata Kosovare e të Shurdhërve  
Udrezenje Gluvih Kosova  
Kosovar Association of the Deaf

Gjuha e shenjave, gjuha jonë  
amtare



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government  
Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-  
Office of the Prime Minister  
Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za  
Dobro Upravljanje/ Office on Good  
Governance



Kjo Broshurë është financuar nga:  
Shoqata Finlandeze e të Shurdhërve

## Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2009-2011

Qeveria e Republikës së Kosovës ka hedhur një hap shumë të rëndësishëm drejt arritjes dhe realizimit të objektivit kryesor të saj për krijimin e kushteve dhe mundësive të barabarta për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, me rastin e aprovimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (2009-2011).

Nga ky moment me seriozitetin më të madh Qeveria e Republikës së Kosovës dhe vet shoqëria jonë është duke bërë hapa konkret shumë të rëndësishëm në realizimin e të gjitha objektivave të parapara me këtë Planin.

Plani i Veprimit bazohet në tetë parime të përgjithshme të përkrahjes së të drejtave të njeriut dhe të pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës:

- Respektimi i dinjitetit të patjetërsueshëm, autonomisë, duke përfshirë lirinë për të marrë vet vendime si dhe pavarësisë së personave me aftësi të kufizuara;
- Jo-diskriminimi;
- Pjesëmarrja e plotë, efikase dhe përfshirja në shoqëri;
- Respekti për dallimet dhe pranimi i personave me aftësi të kufizuara si pjesë e diversitetit apo larmisë njerëzore dhe e humanitetit;
- Mundësitë e barabarta;
- Qasja;
- Barazia midis meshkujve dhe femrave dhe
- Respektimi i kapaciteteve evoluese të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe i të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të ruajtur identitetet e tyre.

## Procesi për zyrtarizimin e gjuhës së shenjave në Republikën e Kosovës

Sigurimi i të drejtave gjuhësore për personat e Shurdhër është një nga prioritetet për të cilat Qeveria e Republikës së Kosovës ka punuar që kjo e drejtë themelore të respektohet dhe të jetësohet edhe në Kosovë.

Procesi për zyrtarizimin e gjuhës së shenjave në Kosovë ka filluar me vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit, për krijimin e Grupit Punues për Zyrtarizimin e Gjuhës së Shenjave.

Këtë proces e kanë përcjellë mbajtja e shumë takimeve, punëtorive konferencave dhe konsultimeve me ekspert vendorë e ndërkombëtar.

Derisa në finalizimin e këtij procesi i udhëhequr nga Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, duke u bazuar në gjendjen ekzistuese të personave të shurdhër si dhe duke ju përmbajtur detyrave të grupit ka dalë me rekomandime për Qeverinë e Republikës së Kosovës që të marrë vendim për njohjen e gjuhës së shenjave. Si dhe krijimi i mundësive që kjo gjuhë të jetë e përfshirë në të gjithë legjislacionin kosovar në mënyrë që të sigurohen të drejtat gjuhësore për personat e Shurdhër në të gjitha aspektet e jetës.

## Publikimi i raportit mbi statusin e personave të Shurdhër në Republikën e Kosovës

Raportit për Statusin e Personave të Shurdhër në Republikën e Kosovës i cili është publikuar për herë të parë në Kosovës ka për qëllim të paraqesë situatën e personave të shurdhër në edukim, arsimim si dhe mundësitë për bashkëveprim dhe qasje në shërbime dhe informacione.

Gjithashtu përbën një hap shumë të rëndësishëm drejt arritjes dhe realizimit të objektivave të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara për zyrtarizimin e gjuhës së shenjave kosovare e cila duhet respektuar dhe duhet mundësuar për personat e shurdhër si një e drejtë e patjetërsueshme.

### Rekomandimet e dalura nga Raporti për Statusin e Personave të Shurdhër të Kosovës janë:

- Qeveria e Republikës së Kosovës me një vendim apo një akt tjetër zyrtar të zyrtarizoj (njohë) gjuhën e shenjave në Republikën e Kosovës
- Qeveria të obligojë institucionet Kosovare për të njohur, për të ofruar shërbime në gjuhën e shenjave, për ta promovuar dhe respektuar gjuhën e shenjave.
- Përmisimin e procesit edukativo-arsimor për komunitetin e të shurdhërve
- Trajnimit për arsimtarët
- Zhvillimi i aftësive mësimore në gjuhën e shenjave
- Përmirësimin dhe provizionet në shërbimet sociale
- Përmirësimin dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore
- Përmirësimi dhe ofrimi e shërbimeve në kulturë dhe media

- Krijimi i hapësirave të cilat lejojnë qasje dhe respektim të gjuhës së shenjave në institucionet shëndetësore, institucionet edukativo-arsimore, institucionet legale, polici dhe institucionet tjera me rëndësi.
- Ngritja e vetëdijes për institucionet dhe qytetarët nga ana e Shoqatës Kosovare të Shurdhërve dhe Zyrës për Qeverisje të Mirë duke lansuar kampanja në lidhje me zyrtarizimin e gjuhës së shenjave menjëherë pas vendimit të Qeveris
- Rekomandohet që Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit së bashku me institucionet tjera relevante të zhvillojnë politika adekuate për implementimin e rekomandimeve të lartpërmendura
- Rekomandohet që ZQM/ZKM së bashku me institucionet tjera relevante të zhvillojnë politika adekuate për implementimin e rekomandimeve të lartpërmendura
- Të gjitha institucionet qoftë ato të nivelit qendror apo lokal duhet të ndajnë fonde për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave
- Institucionet duhet të angazhojnë ekspert vendorë e ndërkombëtar që ndihmojnë procesin e ofrimin të shërbimeve në gjuhën e shenjave
- ZQM/ZKM të ngarkohet me procesin e koordinimit, monitorimit dhe raportimit të procesit të zyrtarizimit të gjuhës së shenjave.